



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 16.02.2023)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projekt-udhëzimit “Për llogaritjen e pagës referuese bazë të magjistratit (gjyqtar)”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:18 dhe mbaroi në orën 13:28.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Irena Plaku*** (anëtare)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)
10. ***Yllka Rupa*** (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Ilir Rusi**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 2. Xhevdet Haxhiu, Drejtor i Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.**
- 3. Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 4. Maela Alicanaj dhe Rezarta Taushani, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**
- 7. Të tjerë: Vladimir Karaj (BIRN).**

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projekt-udhëzimit “Për llogaritjen e pagës referuese bazë të magjistratit (gjyqtar)”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Naureda Llagami: Përshëndetje!

Po fillojmë mbledhjen e radhës të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të datës 16 shkurt.

Siç jeni në dijeni, Këshillit të Lartë Gjyqësor i kërkohet vendimmarrje sot për tetë çështje. Nëse nuk kemi diskutim mbi përmbajtjen e rendit të ditës, atëherë kalojmë me çështjen e parë, e cila ka të bëjë me miratimin e projektudhëzimit “Për llogaritjen e pagës referuese bazë të magjistratit (gjyqtar)” në kuadër të zbatimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 35, datë 22.11.2022.

Për më shumë detaje, fjalën ia jap drejtorit të departamentit.

Xhevdet Haxhiu: Faleminderit Kryetare!

Siç jeni në dijeni dhe siç jeni njohur edhe me relacionin e dërguar në lidhje me një vlerësim të vendimit të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me pagën referuese bazë të magjistratit, Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 35, datë 22.11.2022, pas kërkesës së paraqitur nga Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë, ka shfuqizuar si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të nenit 2, pika 1, të ligjit nr.50./2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar”, i cili ka ndryshuar nenin 12 pika 5, shkronja “a” të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, etj. Me këtë vendim gjykata ka vendosur pranimin e kërkesës duke shfuqizuar, ndër të tjera, nenin 12 pika 5, shkronja “a” të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar me nenin 2, pika 1, të ligjit nr.50/2021, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Gjykata Kushtetuese, në dispozitivin e vendimit, është shprehur se ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare. Ky vendim është publikuar në fletoren zyrtare nr. 3/2023 dhe ka hyrë në fuqi me datën 9 janar 2023.

Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 35, e ka vlerësuar çështjen nën dritën e parimit të pavarësisë së pushtetit gjyqësor dhe ka analizuar qartësisht përlllogaritjen e pagës referuese të magjistratit, përpara dhe pas hyrjes në fuqi të ndryshimit ligjor, që u shfuqizua, si dhe për efektet e vendimit të saj.

Në këtë vendim Gjykata Kushtetuese është shprehur se neni 12, pika 5, shkronja "a", i ligjit nr. 96/2016 në formulimin fillestar referon në kategorinë e parë, në nivelin/klasën më të ulët të kësaj kategorie dhe njësohej me pozicionin e drejtorit të drejtorisë së përgjithshme në Kryeministri ose pozicionet e tjera të barasvlershme me të, ku përfshihen, ndër të tjera, edhe sekretarët e përgjithshëm në njësitë e qeverisjes vendore, paga e të cilëve është klasifikuar në kategorinë I-b, sipas terminologjisë së VKM-së së pagave në kohën e miratimit të ligjit nr. 96/2016 (paragrafi 72 i vendimit të gjykatës).

Elementi "pagë referuese bazë" i pagës mujore bruto të magjistratit i referohet pagës për pozicion të punonjësve të shërbimit civil të kategorisë së parë, klasa e tretë, në pozicionin e drejtorit të drejtorisë së përgjithshme në Kryeministri ose çdo pozicion tjetër

të barasvlershëm me të, që përfshin "shtesën për pozicion" dhe "pagën në grup" sipas grupit të diplomave universitare për këto funksione (paragrafi 74 i vendimit).

Edhe pse dispozita ligjore nuk mbarte paqartësi në lidhje me konceptet ku referonte, zbatimi i saj, jo në linjë me frymën dhe qëllimin e ligjvënësit, ka prodhuar një rezultat të ndryshëm nga ai që ka diktuar vetë norma ligjore, neni 12, pika 5, shkronja "a", i ligjit nr. 96/2016 (paragrafi 78 i vendimit).

Duke krahasuar formulimet e normës ligjore para dhe pas ndryshimeve të saj, ato mbartin diferenca të dukshme në referencat e bëra në drejtim të përcaktimit të elementit të pagës bruto të magjistratit, pikërisht të "pagës referuese bazë" (paragrafi 80 i vendimit).

Pavarësisht mënyrës së zbatimit të normës, në kushtet kur ajo diktonte një mënyre tjetër llogaritjeje të pagës referuese bazë të magjistratit, ndryshimi që i është bërë me ligjin nr. 50/2021, ka sjellë një rezultat, në terma financiare, më të ulët se sa ai që magjistratët do të përfitonin nga zbatimi korrekt i normës origjinale, sipas përmbajtjes së tekstit të saj dhe vullnetit objektiv të treguar nga ligjvënësi në kohën e miratimit të kësaj norme për herë të parë. Për rrjedhojë, formulimi aktual i normës ligjore objekt i gjykimit kushtetues, edhe pse synimi i pretenduar ishte qartësimi i përmbajtjes së saj, në fakt ka sjellë ndryshim të dukshëm të kësaj përmbajtjeje, me pasojë uljen në vlerë të "pagës referuese bazë" e në këtë kuptim uljen e pagës bruto mujore të magjistratit (paragrafi 82 i vendimit).

Gjykata ka arritur në përfundimin së ligjvënësi ka vepruar në kushtet e ndalimit të parashikuar në nenin 138 të kushtetutës, ndaj përmbajtja e shkronjës "a" të pikës 5 të nenit 12 të ligjit nr. 96/2016 duhet të shfuqizohet si e papajtueshme me këtë normë kushtetuese (paragrafi 85 i vendimit të Gjykatës Kushtetuese).

Në lidhje me efektet e vendimit, Gjykata Kushtetuese, duke theksuar rëndësinë e garancive dhe të parimeve kushtetuese me të cilat bien ndesh dispozitat e kundërshtuara, si dhe duke vënë në balancë interesat e mbrojtura kushtetutshmerisht, ka vlerësuar në përputhje me pikën 2 të nenit 132 të Kushtetutës dhe nenin 76, pikat 1, 2 dhe 3, të ligjit nr. 8577/2000, vendimi duhet të hynte në fuqi ditën e publikimit në Fletoren Zyrtare (paragrafi 103 i vendimit).

Gjykata ka vlerësuar të theksojë se ligjvënësi, brenda hapësirës së tij normuese, në formulimin e normës së re ligjore për pagën e magjistratit ka diskrecionin t'i referohet formulës aktuale të referencës në shërbimin civil ose çdo formulë tjetër që referon në legjislacionin në fuqi për pagat e funksionarëve publikë, duke qenë kjo një çështje që i përket oportunitetit të tij. Megjithatë, në ushtrim të kompetencave të tij, në plotësimin e kuadrit ligjor si dhe duke mbajtur parasysh përcaktimet e nenit 138 të Kushtetutës, duke garantuar, në çdo rast, që paga dhe përfitimet e tjera që vijnë si rrjedhojë e zbatimit të sistemit të referencës së pagave, të mos ulen nën standardin e analizuar në këtë vendim, përveçse kur verifikohet përjashtimi sipas nenit 138, shkronja "a", e Kushtetutës (paragrafi 103 i vendimit).

Në lidhje me efektin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, vlerësohet roli kushtetues i saj. Në këtë drejtim, neni 124, paragrafi i parë, i Kushtetutës përcakton se: "Gjykata Kushtetuese zgjidh mosmarrëveshjet kushtetuese dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës", ndërsa neni 131, paragrafi i parë, shkronja "a", i jep kompetencën asaj për të vendosur për pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën. Më tej, neni 132, paragrafi i parë, i Kushtetutës parashikon se: "Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare dhe të detyrueshme për zbatim". Në të njëjtën linjë, lidhur me efektet juridike të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, neni 76, paragrafi i parë i ligjit nr. 8577/2000, përcakton se: "Vendimi i Gjykatës Kushtetuese është përfundimtar dhe i detyrueshëm për zbatim".

Sipas nenit 132, pika 1, të Kushtetutës, vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare dhe të detyrueshme për zbatim. Ato kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare dhe, si të tilla, përbëjnë jurisprudencë kushtetuese, për rrjedhojë kanë efektet e forcës së ligjit. Ky vendim detyrues ka të bëjë si me pjesën urdhëruese, ashtu edhe me pjesën arsyetuese të vendimit (shih vendimet nr. 10, datë 04.03.2021; nr. 49, datë 03.07.2017; nr. 15, datë 01.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese).

Ndikimi i padiskutueshëm i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është i tillë që iu imponon të gjitha organeve shtetërore fuqinë detyruese të arsytimit të vendimit të saj (shih vendimin nr. 17, datë 10.04.2015 të Gjykatës Kushtetuese).

Arsyetimi që përdor gjykata në vendimet e saj ka forcën e ligjit, çka buron nga autoriteti i këtij organi për të thënë fjalën e fundit në çështjet për të cilat të tjerët tashmë

janë shprehur. Çdo qëndrim i kundërt krijon një precedent të rrezikshëm në marrëdhëniet institucionale. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se nga standardi i detyrueshmërisë së zbatimit të vendimmarrjes kushtetuese nuk mund të bëjë përjashtim as vetë Gjykata Kushtetuese (shih vendimet nr. 4, datë 15.02.2021; 78, datë 12.12.2017; nr. 44, datë 29.06.2015 të Gjykatës Kushtetuese).

Në logjikën e këtij vlerësimi, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me shkresën nr. 211, datë 18.01.2023, i ka kërkuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, që në cilësinë e organit përgjegjës dhe më të specializuar për menaxhimin e buxhetit të shtetit, të bëjë një vlerësim se sa do të jetë paga referuese bazë e magjistratit (gjyqtar), nga data 9 janar 2023 e në vazhdim, me qëllim përlllogaritjen e efektit financiar (sipas këtij vendimi), për buxhetin e sistemit gjyqësor.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, me shkresën nr. 2195, datë 02.02.2023, e anë të së cilës i është drejtuar të gjitha institucioneve që preken nga vendimmarrja e Gjykatës Kushtetuese, përfshirë edhe vetë gjykatën, duke vlerësuar se për sa kohë që vendimi nr. 35, i Gjykatës Kushtetuese ka shfuqizuar pikën [...], ai nuk prodhon më efekte juridike, duke lënë të parregulluar nga ana ligjore, deri në miratimin e normës së re nga Kuvendi, një prej elementeve të pagës bruto të magjistratit. Po sipas kësaj shkrese, përlllogaritja e pagave, deri në normimin e ri, duhet të kryhet në të njëjtën mënyrë siç bëhej para vendimit të Gjykatës Kushtetuese, në drejtim të standardit të paprekshmërisë së pagës, sipas nenit 138 të Kushtetutës.

Në kushtet kur nuk ka një normë ligjore që përcakton formën referuese të magjistratit pamundësohet përlllogaritja e pagave të tyre. Për këtë shkak në drejtim të standardit kushtetues për paprekshmërinë e pagës së magjistratit, deri në miratimin e një dispozite që përcakton pagën referuese nga Kuvendi, përlllogaritja e pagave do të vazhdojë të kryhet në të njëjtën mënyrë si më përpara vendimit të gjykatës kushtetuese, duke garantuar në këtë mënyrë respektimin e nenit 138 të Kushtetutës.

Me miratimin e normës së re (thekson Ministria e Financave) nga Kuvendi, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, do të marrë të gjitha masat e nevojshme për përlllogaritjen e efekteve financiare dhe gjetjen e burimeve përkatëse, me qëllim përmbushjen e të gjitha detyrimeve të lindura nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese.

Në vijim të arsyetimit të mësipërm, dua të sjell në vëmendje të Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke qenë se me propozimin që ka bërë edhe Komisioni, do jetë e nevojshme kërkesa për fonde buxhetore shtesë. Sjell në vëmendje se Këshilli i Lartë Gjyqësor, gjatë vitit buxhetor 2022, bazuar në disa vendime të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për një ekonomi gjyqësore dhe mbështetur në përdorimin me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve buxhetore, me vendimin nr. 351, datë 27.7.2022, bazuar në rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit, ka miratuar këto rekomandime, duke vendosur se për të gjithë magjistratët dhe këshilltarët ligjorë jomagjistratë në Gjykatën e Lartë, pavarësisht nga pozicioni i tyre i punës (kategoritë G1, G2 dhe G3), paga referuese bazë të përllogarit mbi bazën e plotë të pagës së Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme në Kryeministri, e cila përbëhet nga paga e grupit, plus shtesën e pagës (që në vlerë absolute është $132,100 = 14,000 + 118.100$), për periudhën nga data 1 janar 2019 deri 28 maj 2021 (për të cilën të gjithë jeni në dijeni).

Në zbatim të këtij vendimi, struktura përgjegjëse për administrimin e buxhetit pranë KLGJ-së realizoi llogaritjen e efektit financiar, e cila në atë kohë rezultoi në shumën 400,000 mijë lekë (30,000 mijë lekë në programin 1110 “Buxheti i KLGJ-së” dhe 370,000 mijë lekë në programin 3310 “Programi i gjykatave”).

Nga një analizë e bërë në momentin e vendimmarrjes së Këshillit për programin 03310, rezultonin fonde të lira në shumën 150,000 mijë lekë dhe në 01110 në shumën 30,000 mijë lekë.

Për këto fonde, Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në vendimin nr. 388, datë 19.09.2022, kërkoi pranë Ministrisë së Financave miratimin e transferimit të shpërndarjes së fondeve buxhetore në programin 03310 në shpenzime korrente, për vitin 2022, për të gjithë gjykatat, me qëllimin e vetëm që të bëjë rishpërndarjen e fondeve dhe të shlyhej detyrimi në mënyrë të barabartë të një pjese të detyrimit të lindur për të gjithë gjykatat e të tre niveleve.

Këshilli i Lartë Gjyqësor i është drejtuar me shkresë me nr. 4930, datë 20.09.2022 (një ditë pas vendimmarrjes i është drejtuar Ministrisë së Financave për këtë qëllim), me shkresën nr. 4930/1, datë 21.9.2022, nr. 4930/2, datë 14.10.2022, nr. 4930/4, datë 21.10.2022 dhe nr. 4930/5, datë 11.11.2022, duke i kërkuar në mënyrë të vazhdueshme Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, miratimin e rishpërndarjes (transferimit) të

fondeve buxhetore, në programin e buxhetit gjyqësor, për vitin 2022, miratim i cili nuk erdhi deri në mbyllje të vitit buxhetor, nuk u krye nga ana e nëpunësit të parë autorizues në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Po ashtu, për diferencën që rezultonte prej 250,000 mijë lekësh, KLGJ-ja e ka përfshirë këtë vlerë në dokumentin e kërkesave buxhetore PBA 23-25, për sistemin gjyqësor, shumë e cila edhe kjo nuk u miratua me ligjin e buxhetit të shtetit për vitin 2023, pjesë e të cilit është edhe buxheti i sistemit gjyqësor.

Pra të ndodhur pari këtij fakti, për vitin buxhetor 2023, është e nevojshme të kërkojmë fonde shtesë, për sa cituam më sipër në shumën 370,000 mijë lekë, duke qenë se shuma 30,000 mijë lekë është shlyer nga programi 1110 (siç jeni në dijeni që janë kryer këto diferenca). Prandaj shuma nga 400, zbrit në 370.

Me hyrjen në fuqi të vendimit nr. 35, të Gjykatës Kushtetuese, jemi në një situatë tjetër ligjore dhe buxhetore.

Pasi sipas arsytimit të Gjykatës Kushtetuese, ajo i referohet kategorizimit të pozicioneve të shërbimit civil sipas ligjit 152/2013, neni 19, sipas kategorive, klasave dhe natyrës së pozicionit.

Në arsytimin e saj në vendimin nr. 35, Gjykata Kushtetuese, në kreun B.1.1. Për cenimin e pagës[...], analizon disa akte ligjore dhe nënligjore, që kanë të bëjnë me elementët e pagës së magjistratit dhe nëpunësit civil.

Në kohën kur u miratua ligji nr. 96/2016, VKM-ja e pagave, në lidhjen nr. 1, rregullonte strukturën dhe nivelin e pagave edhe për nëpunësit civilë në institucionin e Kryeministrit. Struktura e pagave për nëpunësit civilë në këto institucione, pjesë e fushës së veprimit të kësaj VKM-je, bazohet mbi klasifikimin në klasa, që më tej ndaheshin në kategori.

Elementi “shtesë për pozicion” përcaktohet me vlerë fikse për secilën klasë dhe kategori. Klasa e parë ndahet në dy kategori dhe më konkretisht, shtesa për pozicion për kategorinë e parë I-a përcaktohet 129,000 lekë, ndërsa për kategorinë e dytë I-b - 118,000 lekë.

Në referim të legjislacionit të kohës për nëpunësin civil, gjykata vlerëson se neni 12 i ligjit nr. 96/2016 ka përcaktuar qartë dhe mjaftueshëm elementet e pagës mujore bruto të magjistratit dhe elementin “pagë referuese bazë”. Konkretisht, kjo dispozitë ka

përcaktuar se paga referuese bazë është e njëjtë me pagën për funksion të nëpunësve civilë të nivelit më të lartë drejtues, të shprehur në konceptin e kategorisë së parë, klasa e tretë, ku sipas ligjit për nëpunësin civil përfshihet pozicioni i punës “drejtor i drejtorisë së përgjithshme në Kryeministri ose çdo pozicion i barasvlershëm me të”. Fakti se VKM-ja e pagave nuk përmbante klasë të tretë të kategorisë së parë, nuk përbën argument për paqartësi ose boshllëk të nenit 12, pika 5, shkronja “a”, të ligjit nr. 96/2016 në formulimin fillestar. Kjo dispozitë referon në kategorinë e parë, në nivelin/klasën më të ulët të kësaj kategorie dhe njësohej me pozicionin e drejtorit të drejtorisë së përgjithshme në Kryeministri ose pozicionet e tjera të barasvlershme me të, ku përfshihen, ndër të tjera, edhe sekretarët e përgjithshëm në njësitë e qeverisjes vendore, paga e të cilëve është klasifikuar në kategorinë I-b, për të cilën elementi i shtesës për pozicion, sipas terminologjisë së VKM-së së pagave në kohën e miratimit të ligjit nr. 96/2016, ishte në vlerën 118,000 lekë.

Në kuptim të nenit 12 të ligjit nr. 96/2016, Gjykata vëren se elementi “pagë referuese bazë” i pagës mujore bruto të magjistratit sipas shkronjës “a” të pikës 5 të këtij neni, i referohet pagës për pozicion të punonjësve të shërbimit civil të kategorisë së parë, klasa e tretë, në pozicionin e drejtorit të drejtorisë së përgjithshme në Kryeministri ose çdo pozicion tjetër të barasvlershëm me të, që përfshin “shtesën për pozicion” dhe “pagën në grup” sipas grupit të parë të diplomave universitare për këto funksione, e cila sipas VKM nr.545/2011 për pagat i shfuqizuar, VKM nr.817/2017 për pagat, i ndryshuar dhe VKM nr. 621/2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.187/2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar, konsiston në klasën e parë, kategoria e dytë (niveli I-b).

Për sa më sipër, në emër të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, i propozoj seancës plenare, shqyrtimin dhe miratimin e relacionit të sipërcituar si më poshtë:

- Llogaritjen e “pagës referuese bazë” të magjistratit (gjyqtar), nga data 9 janar 2023 e në vazhdim, sipas VKM-së nr. 621/2022, e barabartë me vlerën e “pagës për

funksion” të punonjësit të shërbimit civil Klasa e parë (I), Kategoria e dytë (I-b), niveli I-b.

- “Paga referuese bazë” e magjistratit (gjyqtar), të llogaritet si shumatore e vlerës së “shtesës për pozicion” e përcaktuar në VKM-në 621/2022, në shumën 138,700 lekë me vlerën e “pagës së grupit” në shumën 14,000 lekë, në total në shumën 152,700 lekë (138,700 + 14,000).

- Përlllogaritjen e fondeve buxhetore shtesë për vitin 2023, për sistemin gjyqësor, për periudhën 9 janar 2023 deri 31 dhjetor 2023, duke mbajtur parasysh si “pagë referuese bazë” për funksionet gjyqësore, atë të përcaktuar në pikën 1 dhe 2 të këtij udhëzimi.

Duke ju falënderuar për vëmendjen.

Për ndonjë pyetje të mundshme.

Naureda Llagami: Faleminderit për relatimin.

Atëherë kalojmë tek kolegët, nëse kemi ndonjë diskutim? Pyetje?

Nëse jo, kalojmë në votimin e projekt-aktit.

Irena, se Iliri sot për shkaqe të arsyeshme e ka të pamundur.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli udhëzon:

1. Llogaritjen e “pagës referuese bazë” të magjistratit (gjyqtar), nga data 9 janar 2023 e në vazhdim, sipas VKM-së nr. 621/2022, e barabartë me vlerën e “pagës për

funksion” të punonjësit të shërbimit civil Klasa e parë (I), Kategoria e dytë (I-b), niveli I-b.

2. “Paga referuese bazë” e magjistratit (gjqqtar), të llogaritet si shumatore e vlerës së “shtesës për pozicion” e përcaktuar në VKM-në nr. 621/2022, në shumën 138,700 lekë me vlerën e “pagës së grupit” në shumën 14,000 lekë, në total në shumën 152,700 lekë.

3. Përlllogaritjen e fondeve buxhetore shtesë për vitin 2023, për sistemin gjyqësor, për periudhën 9 janar 2023 deri në 31 dhjetor 2023, duke mbajtur parasysh si “pagë referuese bazë” për funksionet gjyqësore, atë të përcaktuar në pikën 1 dhe 2 të këtij udhëzimi.

4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit në Këshillin e Lartë Gjyqësor për zbatimin e këtij udhëzuesi detyrues.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 16.02.2023)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për detajimin e fondit të veçantë për sistemin gjyqësor, për vitin 2023”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:18 dhe mbaroi në orën 13:28.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Irena Plaku*** (anëtare)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)
10. ***Yllka Rupa*** (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Ilir Rusi**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 2. Xhevdet Haxhiu, Drejtor i Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.**
- 3. Elona Koleka, Drejtoreshë e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 4. Maela Alicanaj dhe Rezarta Taushani, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**
- 7. Të tjerë: Vladimir Karaj (BIRN).**

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për detajimin e fondit të veçantë për sistemin gjyqësor, për vitin 2023”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti i dytë. Edhe ky ka të bëjë me detajimin e fondit të veçantë për sistemin gjyqësor për vitin 2023. Edhe për këtë fjalën ia jap sërish drejtorit të departamentit të buxhetit.

Xhevdet Haxhiu: Faleminderit Kryetare!

Të nderuar anëtarë!

Siç jeni në dijeni, me ligjin nr. 84/2022, “Për Buxhetin e shtetit”, është miratuar buxheti i sistemit gjyqësor në nivel programi, për tre programet që përfshijnë në grupin buxhetor Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Fondi i veçantë i Njësive të Qeverisjes Qendrore nuk është pjesë e fondit të pagave të miratuar me ligjin e buxhetit vjetor. Kështu që, në çdo vit, Ministria e Financës, si ministri përgjegjëse, me nxjerrjen e udhëzimit plotësues, për zbatimin e buxhetit për

vitin 2023, përcakton edhe nivelin e fondeve për çdo njësi shpenzuese të qeverisjes qendrore, pjesë e së cilës është edhe Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Fondi i veçantë, i miratuar për vitin 2023, për të gjithë sistemin gjyqësor është në vlerën 4 500 mijë lekë.

Në zbatim të udhëzimit plotësues, nga ana e njësive të qeverisjes qendrore ky fond detajohet në nivel programi dhe njësie shpenzuese sipas strukturës përkatëse buxhetore në artikullin 606 dhe paraqitet për miratim pranë nëpunësit të parë autorizues, në Ministrinë e Financave. Pasi miratohet ky fond bëhet efektiv në sistemin informatik financiar të qeverisë nga struktura përgjegjëse për buxhetin në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Përdorimi i këtij fondi të veçantë sipas udhëzimit do të bëhet nga njësitë shpenzuese të qeverisjes qendrore në përputhje me kriteret e përcaktuara në VKM nr. 929, datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, i ndryshuar, për përballimin vetëm të shpenzimeve për ndihma të menjëhershme si ndihma për raste fatkeqësie, sëmundje dhe daljet në pension pleqërie, e të tjera, të parashikuara në këtë vendim. Kërkesa për shpenzim së bashku me dokumentacionin përkatës paraqitet në degën e thesarit përkatës. Nëse këto fonde janë të pamjaftueshme, gjatë vitit buxhetor, atëherë bëhet kërkesë për fonde shtesë mbi fondin e akorduar nga njësitë e qeverisjes qendrore dhe e paraqesin për miratim pranë nëpunësit të parë autorizues.

Fondi i veçantë për gjykatat e të gjitha niveleve do të mbahet në programin 03310 “Buxheti Gjyqësor” dhe në çdo rast do të realizohet sipas kërkesave që do të paraqiten nga gjykatat për miratim në Ministri të Financave dhe Ekonomisë, sipas procedurave të përcaktuara për këtë qëllim.

Për sa më sipër, bazuar në legjislacionin për menaxhimin buxhetor, Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, i propozon seancës plenare, detajimin e fondit të veçantë, për grupin buxhetor Këshilli i Lartë Gjyqësor, në shumën prej 4 500 000 lekë, në tre programet si më poshtë: për programin 01110, në shumën 1 200 000 lekë, në programin 01140 (programi i QTI-së) në shumën 100 000 lekë dhe në programin 03310 “Buxheti i gjykatave” në shumën 3 200 000 lekë.

Ju faleminderit për vëmendjen!

Në pritje të ndonjë pyetjeje të mundshme.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, ftoj kolegët nëse s'kanë diskutim, të kalojmë në votimin e projekt-aktit, sipas propozimit të bërë nga Komisioni.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e detajimit të fondit të veçantë, për sistemin gjyqësor, për vitin buxhetor 2023, në vlerën prej 4 500 000 lekë, përkatësisht sipas programeve buxhetore:

- për programin 01110 – në vlerën 1 200 000 lekë,
- për programin 01140 – në vlerën 100 000 lekë,
- për programin 03310 – në vlerën 3 200 000 lekë.

2. Me zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 16.02.2023)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për transferimin e ndihmësit ligjor z. {...}, në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. (relatore znj. Marçela Shehu).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:18 dhe mbaroi në orën 13:28.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Irena Plaku*** (anëtare)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)
10. ***Yllka Rupa*** (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Ilir Rusi**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. **Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
2. **Xhevdet Haxhiu, Drejtor i Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.**
3. **Elona Koleka, Drejtoresh e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
4. **Maela Alicanaj dhe Rezarta Taushani, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
5. **Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
6. **Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**
7. **Të tjerë: Vladimir Karaj (BIRN).**

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për transferimin e ndihmës ligjor z. {...}, në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. (relatore znj. Marçela Shehu).

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti i radhës që ka të bëjë me transferimin e ndihmës ligjor z. {...}, në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Për më shumë detaje, fjalën ia jap zonjës Shehu.

Marçela Shehu: Faleminderit Kryetare!

Pranë Këshillit me datë 20.12.2022 është depozituar një kërkesë, nga ndihmësi ligjor z. {...}, i cili ushtron detyrën e ndihmës ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit që nga data 10.06.2015 dhe në vijim.

Në kërkesën e tij, z. {...}, parashtron faktin se bazuar në nenin 8 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në nenin 42 pika 9 të ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, qëndrimi i tij në këtë detyrë përbën papajtueshmëri ambientale, pasi bashkëshortja e tij, gjyqtarja znj. {...} është kandidatë për ngritje në detyrë pranë kësaj gjykate. Me qëllim shmangien e kësaj pengese ligjore dhe vijimit të procedurave të emërimit të kandidatës znj. {...}, bashkëshortja e tij, në Gjykatën Administrative të Apelit, ka kërkuar transferimin e tij në detyrën e ndihmësit ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Rezulton se, znj. {...} ka kandiduar për ngritje në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 571, datë 07.12.2021.

Në përfundim të procedurës së verifikimit, Këshilli me vendimin nr. 542 datë 24.12.2022 ka vendosur: Kualifikimin e kandidatës dhe vijimin e procedurës së ngritjes në detyrë në këtë gjykatë.

Në vijim, me vendimin nr. 194, datë 27.05.2022 Këshilli ka vendosur fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 571, datë 07.12.2021.

Në përfundim të procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin nr. 571, datë 07.12.2021, Këshilli me vendimin nr. 68, datë 09.02.2023 ka vendosur:

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin nr. 571, datë 07.12.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

- 1) {...}
- 2) {...} [...].

3. Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, [...].

Kandidatët e renditur si më lart nuk kanë ushtruar ankim ndaj vendimit nr. 68, datë 09.02.2023, referuar deklarimeve të tyre në rrugë elektronike më datë 10.02.2023, për rrjedhje vendimi rezulton të jetë bërë përfundimtar.

Në kushtet kur vendimi i Këshillit nr. 68, datë 09.02.2023 “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 571, datë 07.12.2021, të Këshillit” tashmë është përfundimtar dhe i formës së prerë, në zbatim të pikës 68, të vendimit 70/2020, për Këshillin nuk ka më pengesë ligjore për hartimin e projektvendimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 571, të Këshillit.

Në lidhje me shqyrtimin e kësaj kërkesë, rezulton se në nenin 8 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, jepet definicioni i papajtueshmërisë ambientale duke parashikuar se papajtueshmëria ambientale, në kuptimin e këtij neni, krijohet për shkak të lidhjeve të ngushta familjare mes magjistratëve, që janë përkatësisht bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë.

Papajtueshmëria ambientale si kriter ndalues për ngritjen në detyrë edhe në gjykatën e shkallës së dytë, që gjen reflektim në shkronjën “ç”, të pikës 5, të vendimit të Këshillit nr. 571, datë 07.12.2021, është parashikuar gjithashtu pra edhe në nenin 8, pika 2, të ligjit “Për statusin”, ku përcaktohet se: “Këshillat, gjatë ... ngritjes në detyrë të magjistratit, për aq sa është e mundur dhe pa cenuar në mënyrë joproporcionale të drejtën për zhvillimin normal të karrierës profesionale të magjistratit, marrin masa për të shmangur papajtueshmërinë ambientale, sipas pikës 3, të këtij neni, me qëllim që të garantohet besimi i publikut në sistemin e drejtësisë, pavarësia dhe paanësia e magjistratit, efënca e gjykatave dhe zyrave të prokurorisë në dhënien e drejtësisë”. Ndërkohë, kuptimi i papajtueshmërisë ambientale përcaktohet në pikën 1, të kësaj dispozite ligjore, sipas të cilës: “Papajtueshmëria ... krijohet për shkak të lidhjeve të ngushta familjare mes magjistratëve, që janë përkatësisht bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë”. Sa i takon rasteve të papajtueshmërisë ambientale për sa lidhet me ngritjen në detyrë në gjykatën e shkallës së dytë, ato parashikohen në pikën 3, shkronja “a”, të kësaj dispozite ligjore, ku përcaktohet se: “Papajtueshmëri ambientale përbëjnë rrethanat e mëposhtme: a) nëse respektivisht në të njëjtën gjykatë ose prokurori ku magjistrati kërkon të caktohet, ushtron funksionin një magjistrat tjetër, që ndodhet në kushtet e pikës 1 të këtij neni”.

Ndërkohë, neni 42, pika 9 e ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” shprehet lidhur me ndihmësit ligjorë në gjykatat e apelit se: “9. Ndihmësi ligjor, ndihmësi magjistrat ose jomagjistrat u nënshtrohen rregullave të papajtueshmërisë, kufizimeve në detyrë dhe konfliktit të interesave ashtu si magjistrati..”

Neni 66 i ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, shprehet lidhur me transferimin e nëpunësve civilë gjyqësorë: “1. Dispozitat e parashikuara në ligjin “Për nëpunësin civil” për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm aplikohen për aq sa gjejnë zbatim, përveçse kur në këtë ligj parashikohet ndryshe. 2. Transferimi mund të zbatohet vetëm brenda shërbimit civil gjyqësor. 4. Këshilli i Gjykatës njofton Këshillin e Lartë Gjyqësor në rastet kur nëpunësi civil gjyqësor kërkon transferimin në një institucion tjetër të shërbimit civil gjyqësor për shkak të: a) arsyeve mjekësore ose gjatë shtatzënisë; b) paaftësisë shëndetësore; c) shmangies së një situatë të vazhdueshme të konfliktit të interesit.”..

Nga dokumentacioni i administruar nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore pranë Këshillit, rezulton se në organikën e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka një numër të konsiderueshëm pozicionesh të lira në Njësinë e Shërbimit Ligjor.

Bazuar sa më sipër, Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit vlerëson se Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organi kompetent ligjor, duhet të shprehet nëse në rastin konkret jemi ose jo në kushtet e papajtueshmërisë ambientale dhe eventualisht të disponojë në lidhje me transferimin e z. {...}, në një institucion tjetër të shërbimit civil gjyqësor, në kushtet kur ai ka dhënë pëlqimin e tij për këtë transferim.

Sa më sipër, nëse Këshilli vlerëson se në rastin konkret ndodhemi para situatës së papajtueshmërisë ambientale, propozohet më tej miratimi i projektvendimit “Për transferimin e përkohshëm të z. {...}, në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”.

Bashkëngjitur relacionit është edhe projektvendimi përkatës.

Në vlerësimin e Komisionit, nëse zoti {...} dhe zonja {...}, në rastin eventual që do të ngrihet në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, në vlerësimin e Komisionit kjo krijon një situatë të papajtueshmërisë ambientale, në referim të nenit 8 të ligjit “Për statusin” dhe në referim të nenit 42 të ligjit “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”. Ky

është edhe propozimi i Komisionit, pra për shkak të papajtueshmërisë ambientale, të transferohet zoti {...} në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Naureda Llagami: Kemi ndonjë sugjerim?

Jo! Kalojmë në votim projekt-aktin sipas propozimit të Komisionit?

Atëherë, ftoj kolegët nëse s'kanë diskutim, të kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit të bërë nga Komisioni.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord. (*Vota e zotit Toro nuk dëgjohet në audio, por për efekt të procesverbalit, gjatë zbardhjes së tij, i vënë në dijeni për faktin, e ka konfirmuar atë nëpërmjet e-mailit. Cit: "... Vota ka qenë dakord". E-maili me konfirmimin e votës së tij i bashkëlidhet procesverbalit të sigluar.*)

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Transferimin e ndihmësit ligjor z. {...}, në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

2. Efektet juridike të këtij vendimi, fillojnë me hyrjen në fuqi të këtij vendimi.

3. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, brenda 15 ditëve nga dita e njoftimit.

4. Një kopje e vendimit i njoftohet z. {...}, Gjykatës Administrative të Apelit dhe Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 16.02.2023)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit”, përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, (relatore znj.Brikena Ukperaj).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:18 dhe mbaroi në orën 13:28.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Irena Plaku*** (anëtare)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)
10. ***Yllka Rupa*** (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Ilir Rusi**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 2. Xhevdet Haxhiu, Drejtor i Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.**
- 3. Elona Koleka, Drejtoresh e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 4. Maela Alicanaj dhe Rezarta Taushani, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**
- 7. Të tjerë: Vladimir Karaj (BIRN).**

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit”, përparatur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, (relatore znj. Brikena Ukperaj).

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin e radhës, që ka të bëjë me fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit.

Pa humbur kohë, fjalën ia jap zonjës Ukperaj.

Brikena Ukperaj: Faleminderit zonja Kryetare!

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në zbatim të nenit 171, pika 5 të ligjit “Për statusin” si dhe të akteve plotësuese të skemës së vlerësimit, duke filluar nga viti 2020 deri në 31.12.2022, ka filluar me prioritet procesin e vlerësimit etik-profesional me qëllim gradimi për 79 gjyqtarë, për 55 nga të cilët raportet e vlerësimit janë miratuar nga Këshilli, për 2 gjyqtarë projektraportet e vlerësimit i janë dërguar për shqyrtim mbledhjes

plenare, për 2 gjyqtarë projektraportet e vlerësimit kanë përfunduar dhe janë në proces për pritjen e konfirmimit të njoftimit e kundërshtimet e gjyqtarit, për 1 gjyqtar është vendosur pezullimi për shkak të zgjedhjes së tij si anëtar i KLGJ-së, për 5 gjyqtarë është vendosur përfundimi i procedurës së vlerësimit pa vendim përfundimtar, ndërkohë që vijojnë pranë Komisionit dhe relatorëve përkatës procedurat për vlerësimin e 14 gjyqtarëve të tjerë.

Ndërkohë, nga KPK-ja, në mënyrë periodike janë dërguar dosjet e vlerësimit edhe për 20 gjyqtarë të tjerë, vendimet e konfirmimit të tyre në detyrë kanë marrë formë të prerë. Këta gjyqtarë janë: Znj. {...}; z. {...}; z. {...}; znj. {...}; z. {...}; znj. {...}; znj. {...}; znj. {...}; z. {...}, znj. {...}; znj. {...}; znj. {...}; znj. {...}; z. {...}; z. {...}; znj. {...}; znj. {...}; z. {...}; z. {...}. *(në relacion referohet edhe emri i zonjës {...} i cili gjatë lezimit nuk citohet).*

Në këto kushte, në zbatim të nenit 171, pika 5 të ligjit “Për statusin” dhe duke marrë parasysh që nga një verifikim paraprak rezulton që të gjithë gjyqtarët kanë pasur eksperiencë aktive në detyrë më shumë se 1 vit gjatë periudhës së rivlerësimit 2013-2016, i propozohet mbledhjes plenare në pikën e parë të projektvendimit fillimi i procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim gradimin ose përcaktimin e nivelit të vlerësimit për këtë periudhë vlerësimi.

Në pikën e dytë të projektvendimit propozohet caktimi i relatorit dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin për secilin gjyqtar. Lidhur me mënyrën e organizimit të shortit dhe ndarjen e punës, nga ana e Komisionit propozohet në plenare që të ndahen gjyqtarët në dy grupe: Gjyqtarët për të cilët gradimi është përparësi për shkak se ata kanë aplikuar për ngritje në detyrë apo edhe për lëvizje paralele dhe në hapin e dytë është shorti që do të organizohet për gjyqtarët që duhet t’u bëhet gradimi por nuk janë në listën e gjyqtarëve me përparësi, të miratuar edhe nga programet e vlerësimit nga ana e Këshillit.

Për sa i përket hapit të parë të shortit ku propozohet të përfshihen gjyqtarët vlerësimi i të cilëve është përparësi për Këshillin për shkak të lëvizjeve paralele apo ngritjes në detyrë, janë përfshirë gjyqtarët: znj. {...}; z. {...}; z. {...}; znj. {...}; z. {...}; znj. {...}; z. {...} dhe znj. {...}. Janë të gjithë gjyqtarë që kanë aplikuar për ngritje në detyrë në Gjykatën e Lartë apo në Gjykatën e Apelit. Në shortin për përzgjedhjen e relatorit propozohen të përfshihen 3 anëtarët e Komisionit të Përhershëm të Vlerësimit Etik dhe Profesional, me një shpërndarje ngarkese të tillë: znj. Brikena Ukperaj dy

vlerësime; znj. Yllka Rupa tre vlerësime dhe znj. Irena Plaku tre vlerësime. Ndërsa për përzgjedhjen e nëpunësit përgjegjës për vlerësimin, shorti do të realizohet ndërmjet dy nëpunësve të Njësisë së Vlerësimit Etik dhe Profesional, të angazhuar deri tani me vlerësimet periodike të gjyqtarëve, sipas vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263: znj. Gilda Hoxha dhe znj. Esmerilda Habili, duke u ngarkuar secila me nga katër vlerësime.

Në hapin e dytë të shortit të përfshihen dymbëdhjetë gjyqtarët e tjerë të cilët janë: z. {...}; znj. {...}; znj. {...}; znj. {...}; z. {...}; znj. {...}; znj. {...}; znj. {...}; znj. {...}; z. {...}, z. {...} dhe znj. {...}. Në shortin për përzgjedhjen e relatorit propozohen të përfshihen 2 anëtarët e Komisionit të Përhershëm të Vlerësimit Etik dhe Profesional znj. Yllka Rupa dhe znj. Irena Plaku si dhe anëtari zëvendësues gjyqtar i këtij Komisioni, z. Ridvan Hado, me një shpërndarje ngarkese nga katër vlerësime secili. Ndërsa për përzgjedhjen e nëpunësit përgjegjës për vlerësimin, shorti do të realizohet ndërmjet dy nëpunësve të Njësisë së Vlerësimit Etik dhe Profesional, të angazhuar deri tani me vlerësimet, znj. Gilda Hoxha dhe znj. Esmerilda Habili, me një ngarkesë pune nga gjashtë vlerësime secili.

Lidhur me procedurën e shortit, Komisioni propozon të fillohet me përzgjedhjen e relatorit për secilin gjyqtar, e më pas vijohet me përzgjedhjen e nëpunësit përgjegjës për vlerësimin, duke futur për çdo hap shorti, në një vazo emrat e gjyqtarëve, në një vazo tjetër emrat e relatorëve aq herë sa numri i procedurave të vlerësimit që ata do të përfshihen dhe në një vazo tjetër emrat e nëpunësve përgjegjës, duke zbatuar edhe për këta të fundit të njëjtin parim si për relatorin.

Faleminderit!

Procedura për hapin e parë të shortit si vijon:

Futen në enën e parë të qelqit shiritat e letrës me emrat e gjyqtarëve sipas kësaj radhe: znj. {...}; z. {...}; z. {...}; znj. {...}; z. {...}; znj. {...}; z. {...} dhe znj. {...}.

Futen në enën e dytë të qelqit shiritat e letrës me emrat e relatorëve: znj. Brikena Ukperaj (futen dy shirita me emrin e saj); znj. Irena Plaku (futen tre shirita me emrin e saj) dhe znj. Yllka Rupa (futen tre shirita me emrin e saj).

Futen në enën e tretë të qelqit shiritat e letrës me emrat e nëpunësve përgjegjës: znj. Gilda Hoxha (futen katër shirita me emrin e saj); znj. Esmerilda Habili (futen katër shirita me emrin e saj).

Procedura e përzgjedhjes si vijon:

Përzgjidhet gjyqtari me nr. 4, znj. {...}. Relatore përzgjidhet znj. Yllka Rupa dhe nëpunës përgjegjës përzgjidhet znj. Esmerilda Habili.

Përzgjidhet gjyqtari me nr. 18, znj. {...}. Relatore përzgjidhet znj. Yllka Rupa dhe nëpunës përgjegjës përzgjidhet znj. Gilda Hoxha.

Përzgjidhet gjyqtari me nr. 14, znj. {...}. Relatore përzgjidhet znj. Irena Plaku dhe nëpunës përgjegjës përzgjidhet znj. Esmerilda Habili.

Përzgjidhet gjyqtari me nr. 9, z. {...}. Relatore përzgjidhet znj. Yllka Rupa dhe nëpunës përgjegjës përzgjidhet znj. Esmerilda Habili.

Përzgjidhet gjyqtari me nr. 11, z. {...}. Relatore përzgjidhet znj. Brikena Ukperaj dhe nëpunës përgjegjës përzgjidhet znj. Esmerilda Habili.

Përzgjidhet gjyqtari me nr. 8, z. {...}. Relatore përzgjidhet znj. Brikena Ukperaj dhe nëpunës përgjegjës përzgjidhet znj. Gilda Hoxha.

Përzgjidhet gjyqtari me nr. 13, z. {...}. Relatore përzgjidhet znj. Irena Plaku dhe nëpunës përgjegjës përzgjidhet znj. Gilda Hoxha.

Përzgjidhet gjyqtari me nr. 6, znj. {...}. Relatore përzgjidhet znj. Irena Plaku dhe nëpunës përgjegjës përzgjidhet znj. Gilda Hoxha.

Procedura për hapin e dytë të shortit si vijon:

Futen në enën e parë të qelqit shiritat e letrës me emrat e gjyqtarëve sipas kësaj radhe: z. {...}; znj. {...}; znj. {...}; znj. {...}; z. {...}; znj. {...}; znj. {...}; znj. {...}; znj. {...}; z. {...}, z. {...} dhe znj. {...}.

Futen në enën e dytë të qelqit shiritat e letrës me emrat e relatorëve: znj. Yllka Rupa (futen 4 shirita me emrin e saj); znj. Irena Plaku (futen 4 shirita me emrin e saj) dhe z. Ridvan Hado (futen 4 shirita me emrin e tij).

Futen në enën e tretë të qelqit shiritat e letrës me emrat e nëpunësve përgjegjës: znj. Gilda Hoxha (futen 6 shirita me emrin e saj); znj. Esmerilda Habili (futen 6 shirita me emrin e saj).

Procedura e përzgjedhjes si vijon:

Përzgjidhet gjyqtari me nr. 12, znj. {...}. Relatore përzgjidhet znj. Yllka Rupa dhe nëpunës përgjegjës përzgjidhet znj. Gilda Hoxha.

Përzgjidhet gjyqtari me nr. 3, z. {...}. Relator përzgjidhet z. Ridvan Hado dhe nëpunës përgjegjës përzgjidhet znj. Esmerilda Habili.

Përzgjidhet gjyqtari me nr. 1, znj. {...}. Relator përzgjidhet z. Ridvan Hado dhe nëpunës përgjegjës përzgjidhet znj. Esmerilda Habili.

Përzgjidhet gjyqtari me nr. 16, znj. {...}. Relatore përzgjidhet znj. Yllka Rupa dhe nëpunës përgjegjës përzgjidhet znj. Esmerilda Habili.

Përzgjidhet gjyqtari me nr. 10, znj. {...}. Relator përzgjidhet znj. Yllka Rupa dhe nëpunës përgjegjës përzgjidhet znj. Esmerilda Habili.

Përzgjidhet gjyqtari me nr. 5, znj. {...}. Relator përzgjidhet znj. Irena Plaku dhe nëpunës përgjegjës përzgjidhet znj. Gilda Hoxha.

Përzgjidhet gjyqtari me nr. 19, z. {...}. Relator përzgjidhet z. Ridvan Hado dhe nëpunës përgjegjës përzgjidhet znj. Gilda Hoxha.

Përzgjidhet gjyqtari me nr. 15, znj. {...}. Relator përzgjidhet z. Ridvan Hado dhe nëpunës përgjegjës përzgjidhet znj. Gilda Hoxha.

Përzgjidhet gjyqtari me nr. 20, z. {...}. Relatore përzgjidhet znj. Irena Plaku dhe nëpunës përgjegjës përzgjidhet znj. Gilda Hoxha.

Përzgjidhet gjyqtari me nr. 2, z. {...}. Relatore përzgjidhet znj. Irena Plaku dhe nëpunës përgjegjës përzgjidhet znj. Esmerilda Habili.

Përzgjidhet gjyqtari me nr. 7, znj. {...}. Relatore përzgjidhet znj. Irena Plaku dhe nëpunës përgjegjës përzgjidhet znj. Gilda Hoxha.

Përzgjidhet gjyqtari me nr. 17, znj. {...}. Relatore përzgjidhet znj. Yllka Rupa dhe nëpunës përgjegjës përzgjidhet znj. Esmerilda Habili.

Naureda Llagami: Atëherë, pas hedhjes së shortit, jemi dakord me projekt-aktin në tërësi?

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

I. Fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, për të cilët janë dorëzuar në vijim nga organet e rivlerësimit, dosjet me aktet e vlerësimit profesional.

II. Caktimin e relatorit dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin për secilin gjyqtar, si më poshtë:

1. Për gjyqtaren znj. {...} – Relator z. Ridvan Hado – Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili.

2. Për gjyqtarin z. {...} – Relator znj. Irena Plaku – Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili.

3. Për gjyqtarin z. {...} – Relator z. Ridvan Hado – Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili.

4. Për gjyqtaren znj. {...} – Relator znj. Yllka Rupa – Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili.

5. Për gjyqtaren znj. {...} – Relator znj. Irena Plaku – Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha.

6. Për gjyqtaren znj. {...} – Relator znj. Irena Plaku – Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha.

7. Për gjyqtaren znj. {...} – Relator znj. Irena Plaku – Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha.

8. Për gjyqtarin z. {...} – Relator znj. Brikena Ukperaj – Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha.

9. Për gjyqtarin z. {...} – Relator znj. Yllka Rupa – Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili.

10. Për gjyqtaren znj. {...} – Relator znj. Yllka Rupa – Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili.

11. Për gjyqtarin z. {...} – Relator znj. Brikena Ukperaj – Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili.
12. Për gjyqtaren znj. {...} – Relator znj. Yllka Rupa – Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha.
13. Për gjyqtarin z. {...} – Relator znj. Irena Plaku – Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha.
14. Për gjyqtaren znj. {...} – Relator znj. Irena Plaku – Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili.
15. Për gjyqtaren znj. {...} – Relator z. Ridvan Hado – Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha.
16. Për gjyqtaren znj. {...} – Relator znj. Yllka Rupa – Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili.
17. Për gjyqtaren znj. {...} – Relator znj. Yllka Rupa – Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili.
18. Për gjyqtaren znj. {...} – Relator znj. Yllka Rupa – Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha.
19. Për gjyqtarin z. {...} – Relator z. Ridvan Hado – Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha.
20. Për gjyqtarin z. {...} – Relator znj. Irena Plaku – Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 16.02.2023)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të datave 16.01.2023, 18.01.2023, 19.01.2023, 23.01.2023, 27.01.2023.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:18 dhe mbaroi në orën 13:28.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Klodian Kurushi** (anëtar)
- 3. Fatmira Luli** (anëtare)
- 4. Irena Plaku** (anëtare)
- 5. Dritan Hallunaj** (anëtar)
- 6. Ridvan Hado** (anëtar)
- 7. Alban Toro** (anëtar)
- 8. Marçela Shehu** (anëtare)
- 9. Brikena Ukperaj** (anëtare)
- 10. Yllka Rupa** (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Ilir Rusi**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 2. Xhevdet Haxhiu, Drejtor i Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.**
- 3. Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 4. Maela Alicanaj dhe Rezarta Taushani, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**
- 7. Të tjerë: Vladimir Karaj (BIRN).**

RENDI I DITËS:

5. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të datave 16.01.2023, 18.01.2023, 19.01.2023, 23.01.2023, 27.01.2023.

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti i radhës që ka të bëjë me miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Respektivisht janë të datave 16 janar, 18 janar, 19 janar, 23 janar dhe 27 janar, procesverbale të cilat ju janë përcjellë nga administrata. Ju ftoj që t'i miratojmë për të lejuar publikimin e tyre.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave 16.01.2023, 18.01.2023, 19.01.2023, 23.01.2023 dhe 27.01.2023.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi dhe publikimin e këtyre procesverbaleve Kryetarja e Këshillit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: Viojmë mbledhjen me dyer të mbyllura për shqyrtimin e tre çështjeve të tjera.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor